



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**VENDIM**

**NR. 2 DATË 04. 07. 2013**

**PËR MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E  
11 (NJËMBËDHJETË) HIDROCENTRALEVE TË KASKADËS MBI LUMIN CURRAJ,  
ME INVESTITOR SHOQËRINË “TELEMENIA CURRAJ” sh.p.k, RRETHI TROPOJË,  
QARKU KUKËS**

Në mbështetje të neneve 8, 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10 119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 502, datë 13.07.2011, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM. nr. 848, datë 06.12.2011 “Për miratimin e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT”, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimit të shoqërive “Telemenia ALB” sh.a & “F.K. Generators Equipment” ltd & “Melta Inter Industries” ltd për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj”, si dhe VKM nr. 87 datë 07.02.2012 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit


**V E N D O S I :**

1. Miratimin e lejes zhvillimore komplekse për ndërtimin e 11 (njëmbëdhjetë) hidrocentraleve të kaskadës mbi lumin Curraj, me investitor shoqërinë “Telemenia Curraj” sh.p.k, Rrethi Tropojë, Qarku Kukës, përfshirë dhe materialin grafik, si pjesë përbërëse e kësaj leje.
2. Lëshimi i lejes zhvillimore komplekse nga METE dhe ekzekutimi i saj, do të bëhet njëkohësisht për 11 hidrocentralet e kaskadës së lumit Curraj, Qarku Kukës.
3. Fillimi i punimeve të ndërtimit do jetë brenda muajit Korrik 2014.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**SALI BERISHA**

  
**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**  
**SOKOL OLLDASHI**



**MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**

**SEKRETARE E KKT**

**KREUZA LEKA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

